

V E N D I M
Nr.82, datë 18.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Zija Vuci, Anëtar i “““

Gjergj Sauli, Anëtar i “““

Alfred Karamuço, Anëtar i “““

Kristofor Peçi, Anëtar i “““

Petrit Plloçi, Anëtar i “““

Tefta Zaka, Anëtare e “““

Sokol Sadushi, Anëtar i “““

Kujtim Puto, Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 17.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.102 Akti që i përket:

KËRKUES: 1. LEKË ÇUKAJ, kandidat për deputet i Partisë Socialiste.

2. MARK KROQI, përfaqësohet me deklaram nga avokat Bujar Hoti.

SUBJEKTE TË INTERESUAR: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Sokol Lamaj.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i pjesshëm i vendimit nr.171, datë 13.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kërkuesit kanë parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin pjesërisht të vendimit të mësipërm:

Kërkuesi Lekë Çukaj:

- Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për shpalljen të pavlefshme të zgjedhjeve në 13 qendra votimi është pjesërisht i pabazuar në ligj e në të gjitha materialet që disponon Komisioni i Zonës Zgjedhore nr.2 Shkodër dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve Tiranë.

- Në 8 qendra votimi: nr.10 Postribë; nr.1, 2, 5, 7, 9 Shalë; nr.1 Shllak e nr.9 Temal janë zhvilluar rregullisht zgjedhjet pa u bërë vërejtje nga anëtarët e komisionit.

Kërkuesi Mark Kroqi:

- Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pa të drejtë ka nxjerrë të pavlefshme votimet në qendrat e votimit nr.3 Shkrel; nr.9 Temal; nr.2, 5 e 6 Shllak e nr.1 Shalë.

- Nuk jemi para rasteve që parashikon neni 113 i Kodit Zgjedhor për pavlefshmërinë e votimit në këto qendra sepse nuk ka shkelje të ligjit. Të gjithë komisionerët kanë nënshkruar pa vërejtje procesverbalet e këtyre qendrave të votimit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kujtim Puto, kërkuesit dhe përfaqësuesit e tyre, përfaqësuesin e subjektit të interesuar, u njoh me përmbajtjen e dokumenteve të dosjes dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.171, datë 13.7.2001 ka vendosur të mos shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.2 dhe ka shpallur të pavlefshme zgjedhjet në qendrat e votimit nr.3 Shkrel; nr.10 e 14 Postribë; nr.1, 2, 5, 7, 9 Shalë; nr.1, 2, 5, 6 Shllak si dhe në qendrën e votimit nr.9 Temal, duke urdhëruar përsëritjen e zgjedhjeve në këto qendra votimi në datën 22 korrik 2001.

Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është i drejtë. Procesi i votimit në të 13 qendrat e votimit është kryer me mangësi e parregullsi të shumta të cilat kanë ndikuar në rezultatet e zgjedhjeve në disa qendra votimi. Për më tepër, në Komisionin e Zonës Zgjedhore kutitë e votimit kanë ardhur të

hapura gjë që vërteton pretendimet e kërkuarit Lekë Çukaj për parregullsi e shkelje ligji në 6 qendra votimi si dhe pretendimet e kërkuarit Mark Kroqi për parregullsi e shkelje ligji në 8 qendra votimi.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/e të Kushtetutës; neneve 26 dhe 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” si dhe nenit 113 të Kodit Zgjedhor, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesave.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

MENDIMI I PAKICËS

Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nuk është i bazuar në ligj e në prova përse i përket shpalljes së pavlefshme të zgjedhjeve në qendrat e votimit nr.1 Shalë, nr.9 Temal, nr.10 Postrinë dhe nr.1 Shllak.

Të dy kandidatët rivalë për deputet pranuan se si votimi ashtu edhe tabelat e rezultateve në qendrat e votimit nr.1 Shalë dhe nr.9 Temal janë në konformitet me Kodin Zgjedhor. Si rrjedhojë duke mos pasur asnjë kundërshtim nga të dy palët dhe asnjë vërejtje nga komisionerët në qendrat e votimit e në zonën zgjedhore, nuk është e legjitimuar shpallja e pavlefshme e zgjedhjeve dhe përsëritja e tyre në këto dy qendra votimi. Konstatimi se këto kuti votimi kanë ardhur të hapura në Komisionin e Zonës Zgjedhore nuk të çon në çdo rast në shpalljen të pavlefshëm të votimit. Në këtë rast votimi mund të konsiderohet i tillë kur subjektet elektorale (përfshi edhe kandidatët) kontestojnë procesverbalet për tabelat e rezultateve apo vendimet përkatëse të komisioneve por jo kur ata pranojnë si të vërteta rezultatet e shënuara në to.

Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve vjen në kundërshtim me ligjin e provat edhe përse i përket urdhërimit për rivotim në qendrën e votimit nr.10 Postrinë. Në këtë të fundit zgjedhjet janë zhvilluar normalisht dhe rezultati është pranuar nga anëtarët e Komisionit të Qendrës së Votimit dhe anëtarët e Komisionit të Zonës Zgjedhore, përfshirë edhe anëtarët e koalicionit “Bashkimi për Fitore”, të cilët i kanë pranuar rezultatet duke mos bërë asnjë vërejtje. Për më tepër, nga procesverbali i mbajtur në takimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me Komisionin e Zonës Zgjedhore nr.2, del se kutia e votimit ka ardhur e rregullt në Komisionin e Zonës Zgjedhore.

Zgjedhjet nuk duhet të përsëriten edhe në qendrën e votimit nr.1 Shllak sepse për zhvillimin normal të tyre pretendon jo vetëm kandidati socialist Lekë Çukaj, por edhe kandidati rival Mark Kroqi, duke paraqitur deklaratën noteriale (nr.447 Rep. E nr.409 Kol., datë 16.7.2001) të zv/kryetarit të qendrës së votimit, Tom Zojza. Ky i fundit ka nënshkruar pa vërejtje edhe tabelën përkatëse të rezultateve të asaj qendre.

ANËTAR
K. Puto